

FRAZELOGJIA SHQIPE PËRBALLË ASAJ ITALIANE

Irena LAMA (NDOCI)

Departamenti i Gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës,
SHQIPËRI

E-mail: irenalama@yahoo.it

PËRMBLEDHJE

Prej gati një shekulli është debatuar për rëndësinë e përkthimit të kryeveprave të letërsisë botërore për pasurimin e gjuhës, të kulturës dhe të letërsisë shqipe. Kryevepra e shkrimtarit italian Xhovani Verga *I Malavoglia*, është një ndër veprat që përmbush më së miri këtë tezë. Nëpërmjet analizës dhe krahasimit të frazeologjisë, proverbave e fjalëve të urta të përdorura në origjinal dhe në variantin shqip *Shtëpia e Malavolajve*, mund të nxirret në pah se si përkthimi i romaneve të këtij lloji, jo vetëm i shërben pasurimit të gjuhës dhe të kulturës tonë, por mund të shërbejë edhe si praktikë e mirë për përkthyesit e veprave artistike.

Fjalët kyçe: *përkthimi, frazeologjia, analiza dhe krahasimi, I Malavoglia e Xhovani Vergës, varianti shqip Shtëpia e Malavolajve.*

HYRJE

Baza e këtij punimi janë vepra në origjinal e Vergës *I Malavoglia* dhe ajo e përkthyer nga Filip Ndocaj *Shtëpia e Malavolajve*. Romani, një ndër më të famshmit e letërsisë italiane për risitë e tij stilistikore, bie në sy edhe për përdorimin e bollshëm të fjalëve të urta, proverbave, gjysëmproverbave, aforizmave, krahasimeve me kafshë, togfjalëshave të qëndrueshëm, nofkave të spikatura. Arsyeja e këtij studimi është të vërehet si ka ardhur kjo

frazeologji (në kuptimin e gjerë të fjalës, pra duke përfshirë këtu përveç shprehjeve frazeologjike edhe proverbat, fjalët e urta, etj.) në gjuhën shqipe. Objektivat janë të qarta: nëpërmjet analizës dhe krahasimit të frazeologjisë të përdorur në origjinal dhe në variantin shqip, do të shihet si i ruan karakteristikat e veçanta vepra në shqip dhe si e ka zgjidhur problemin e frazeologjisë përkthyesi. Romani është një burim i vlefshëm për fjalorët Frazeologjikë dhe një praktikë e mirë për përkthyesit e veprave artistike. Kjo është edhe rëndësia e këtij studimi.

Rëndësia dhe vlera e përkthimit të veprave të letërsisë botërore në shqip ka qenë një ndër temat e preferuara të debatit që në fillimet e shekullit XX. Në radhë të parë përkthimi i veprave të letërsisë botërore është parë si mjet për pasurimin e gjuhës dhe të kulturës shqipe. Autorë të ndryshëm nxisnin përkthyesit që të punonin pa pushim sepse përkthimet ishin njëri prej ushqimeve të gjuhës shqipe. Kërkohej që të bëhej një përzgjedhje e kujdesshme e kryeveprave botërore të shkrimtarëve të mëdhenj. Këto vepra duhet të ishin serioze dhe duhet të ndihmonin popullin në rregullimin e jetës së tij, në zhvillimin e ndjesive, të mendimit, të kulturës dhe të moralit, pasi ndonjë herë ishte vënë re përkthimi i veprave pa vlerë për lexuesin shqiptar.

Debati bëhej jo vetëm për përmbajtjen, por edhe për gjuhën që duhej përdorur në veprat e përkthyer. Pati mendime pro dhe kundër tezës që gjuhët klasike kishin rëndësi për formimin e letrarëve të rinj shqiptarë. Pati kritika dhe replika për përdorimin e dialektit të veriut, u bënë recensionet për përkthime të ndryshme, u bënë analiza të përkthimeve, u vunë në dukje dobësitë e konstatuara në dhjetëvjeçarin 1920-1930 në letërsinë shqipe dhe në përkthim, u kritikua vërshimi i letërsisë së huaj të verdhë, u dhanë shembuj të veprave të përkthyer me mjeshtëri, u bënë edhe vërejtje për kopjime nga letërsia e huaj, etj.

Ndërkohë që pranohej njëzëri që përkthimi udhëhiqte dhe pasuronte edhe letërsinë dhe kulturën shqiptare, i kushtohej një vëmendje e veçantë përdorimit të një gjuhe të kuptueshme nga jugu në veri dhe jepeshin edhe mendime se cila ishte gjinia që duhej të përkthehej më shumë. Në vitin 1930 u shpreh mendimi se lloji më i përshtatshëm për publikun shqiptar ishte komedia. Përkthimi i komedive të huaja mund të përgatiste autorin shqiptar të komedive dhe dramave origjinale shqiptare.

Në procesin e nxitjes së përkthimeve nga gjuhë të huaja, jepeshin edhe artikuj të autorëve të huaj për përkthimet. Me gjithë fushatën e ndërmarre për të përkthyer sa më shumë vepra me «brumë», përkthimet dhe prezantimet e letërsisë së huaj nuk qenë të mjaftueshme dhe cilësore.

Në vitin 1944 u shtrua çështja e cilësisë, kontrollit dhe sistemimit të përkthimeve. Arshi Pipa shprehu mendimin se letërsia e huaj jo vetëm shërbente si model për letërsinë dhe gjuhën shqipe, por ai theksonte se përkthimi duhej t'i përshtatej gjuhës në të cilën përkthehej. Duhej parë me kujdes stili i originalit. Parimi bazë duhej të ishte përkthimi sipas natyrës së gjuhës në të cilën përkthehet.

Nisur nga kjo klimë, përkthyesit tanë janë përpjekur që të sjellin më të mirën e letërsisë botërore në shqip edhe pse shumë herë me vite vonësë. Romani i shkrimtarit italian *Familja e Malavolajoe*, që u botua në Shqipëri tetëdhjetë vjet mbas botimit në Itali, në vitin 1961, mund të konsiderohet si një fjalor proverbash, fjalësh të urta, shprehjesh frazeologjike (fenomen i hasur edhe në shkrimtarë të

tjërë italianë si Dante, Petrarca, Manzoni, Verga, Moravia, Paveze, etj). Proverbat dhe fjalët e urta të përfshira aty janë rreth 215, ndërsa shprehjet frazeologjike gati dyfish.

Pra përkthimi i kësaj vepre, veç të tjerash, përfshin problemin e frazeologjisë, të proverbave dhe të fjalëve të urta. Për të përkthyer një vepër të tillë çdo përkthyes ka nevojë për fjalorë frazeologjikë, proverbash e fjalësh të urta. Përpjekje për grupimin e shprehjeve frazeologjike, proverbave e fjalëve të urta janë bërë nga autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj që në shek. XVII. Studiues shqiptarë dhe të huaj studiuuan frazeologjinë e veprave të veçanta, togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë të gjuhës shqipe, etj.

Mbas një analize të përkthimit të dy teksteve zakonisht bëhet pyetja: a kishte gabime? Në fakt qëllimi i kësaj analize nuk ishte gjetja e gabimeve (për hir të së vërtetës nuk kishte të tilla), por problemet që nxjerr përkthimi i një romani me një pasuri të tillë frazeologjike dhe si paraqitet frazeologjia shqipe përballë asaj italiane.

Gjatë romanit disa proverba, fjalë të urta e shprehje përsëriten pa asnjë ndryshim në gojën e të njëjtit personazh ose nga personazhe të ndryshme, mirëpo përkthyesi i sjell në shqip të ndryshme:

Chi fa credenza senza pegno, perde l'amico, la roba e l'ingegno.

1. Kush jep me kredi, pa peng dhe pa qefilë – humbet mikun, mallin dhe fuqinë!

2. Kush jep borxh pa marrë peng – humbet mikun, pasurinë dhe dëronë.

Quel ch'è di patto non è d'inganno.

1. Nga del fjala, del shpirti.

2. Ç'bëhet me të ujdurur s'ka si të jetë mashtrim.

Chi cade nell'acqua per forza che si bagni.

1. Kush bie në ujë, doemos që laget!

2. Kush bije në ujë, pa tjetër që do njomet!

Ad ogni uccello il suo nido è bello:

1. Secilit zog, mbi çdo tjetër, i pëlqen foleja e vet.

2. Çdo zogu foleja e tij i duket e bukur.

Chi cambia la vecchia per la nuova, peggio trova.

1. Kush ndrron të vjetrën për të renë – bie keq sa çudit dhenë!

2. Kush ndrron plakën për të renë, më keq gjenë.

Tenere il sacco.

1. I mban anën.
2. I mban ison.

Pestare l'acqua nel mortaio.

1. Si të mihësh në ujë.
2. Rrihte ujë në havan.
3. Si të shtypte ujë në havan.

Cercare il pelo nell'uovo.

1. Përpiqen të gjejnë shkaqe.
2. Ta stërhollonte aq gjatë muhabetin.

Mettera a sacco e a fuoco:

1. T'i vinin zjarrin dhe ta plaçkisinin.
2. Për ta grabitur dhe t'i vinin flakën.

Ka raste që proverbi ose shprehja kanë kuptim të ndryshëm në varësi të kontekstit, por përkthyesi përdor përsëri të njëjtin proverb a shprehje shqipe. Në rastin e mëposhtëm shprehja *pestare l'acqua nel mortaio*, në të njëjtën faqe është përdorur me kuptime të ndryshme: në rastin e parë: *këmbëngulte në idenë se...* në rastin e dytë *mih në ujë*, por përkthyesi përdor të njëjtën shprehje shqipe: "... mbas dreke, dhe zuri të mihte në ujë se kështu bota nuk ecte mirë fare, ... Por me njerëz si këta ishte tamam si të mihësh në ujë". (Kap. XII, faqe 245).

Ka edhe raste kur dy proverba ose shprehje të ndryshme përkthehen me të njëjtin proverb a shprehje në shqip:

Chi va con zoppi, all'anno zoppica.

Kush fle me qen, çohet me pleshta;

Chi va col lupo allupa.

Kush flet me qent, çohet me pleshta.

Ka shumë shprehje që janë përkthyer fjalë për fjalë. Pyetja e parë që lind është: Edhe në shqip ekziston një e tillë apo në pamundësi për të gjetur proverbin, fjalën e urtë apo shprehjen shqipe përkthyesi ka bërë përkthimin fjalë për fjalë?

Donna di telaio, gallina di pollaio, e triglia di gennaio.

Grua e tezgjahut, pula e furrikut dhe lica e janarit.

Senza pilota barca non cammina.

S'ikën varka pa varkarin!

Chi la vuol cotta e chi la vuol cruda.

Kush e do të pjekur e kush e do të zjerë.

Casa mia, madre mia.

Shtëpia ime, nëna ime.

Non si faceva bere l'asino per forza.

Gomarit nuk i jepej ujë me pahir.

Përkthimi fjalë për fjalë jo gjithmonë përcjell idenë e Vergës. Kështu p.sh në kapitullin XII në faqen 247 është dhënë përkthimi: «... por a e dini se çfarë thonë në mes tyre? *Nxjerrin shkumë nga goja*, duket sikur nga çasti në çast do kapin njëri tjetrin për gryke...». Shprehjen *Fare la schiuma alla bocca* Verga e merr nga shprehja siciliane *fari scumazza – parlare inutilmente*. Në shqip të thuash *nxjerr shkumë nga goja* dhe të *flasësh kot më kot* nuk janë e njëjta gjë. Përkthimi fjalë për fjalë jo gjithmonë të nxjerr pa lagur...

Disa herë përkthyesi krijon të ashtuquajturin inflacion frazeologjik: për një proverb italian, rreshton dy a më shumë në shqip:

Necessità abbassa nobiltà.

Nevoja s'ka gjyq ose Në varfëri s'mbahet dot fisnikëri.

Pari con pari e statti coi tuoi.

Eshi eshi, rrasa vegshin ose Fiku nën fik duhet të bjerë.

Degli uomini segnati guardatene.

Ruaju nga njerëzit sakatë; ruaju nga të gjymtuarit; Nga të gjymtuarit nga Zoti, njëqind hapa larg, nga një çalaman njëqind e tetë!

E kundërta (një fjalë shqipe të përmbledhë disa italiane), ndodh rrallë. Në fjalën e urtë të sjellë më poshtë me fjalën "kurora", përkthyesi nënkupton edhe kurorën e martesës edhe atë të fesë:

Matrimoni e vescovadi dal cielo sono destinati. Kurora zbret nga qielli.

Ndonjëherë proverbi ose fjala e urtë nuk ndjehen si të tilla sepse ndërpriten nga sqarime ose fjalë në mes:

Quando uno è galantuomo lascia buon nome e si guadagna il paradiso. – ..., kur ai që ka vdekur vdes i ndershëm, (sic qe Bastjanacua i varfër), lë pas një emër të nderuar dhe në atë jetën tjetër fiton paraajsën.

Il tempo si porta via le cose brutte come le cose buone. Koha (kishte kaluar, dhe duke kaluar ajo) merr me vete edhe gjërat e liga dhe të mirat.

Le ragazze vanno come Dio le ha destinate. Çupat (– ikin nga shtëpia e prindërve), shkojnë aty ku ua ka caktuar fatin Zoti.

Në shumë raste përkthyesi ka përdorur me mjeshtëri rimën:

Contentati di quel che t'ha fatto tuo padre; se non altro non sarai un birbante. – Kënaqu me zana-

tin e t'yt eti, të paktën s'do të bëhesh kusar deti.

Il mondo è tondo, chi nuota e chi va a fondo.

– Bota është me rrota: kush noton e kush mbytet e në fund shkon.

Cento mani Dio benedisse, ma non tutte in un piatto! – Duar shumë bekue, gojë shumë mallkue.

Il mondo è pieno di guai, chi ne ha pochi e chi ne ha assai. – Bota nga hallet është bërë trokë, kush ka pak e kush i ka me okë.

Fa il mestiere che sai, che se non arricchisci camperai. – Zanatin mësoje dhe lëre, kur të të marrë urija, zëre!

Chi non sa l'arte chiuda bottega, e chi non sa nuotare che si anneghi. – Kush s'e njeh zananë, të mbyllë dyqanë; dhe kush s'di të notojë, të mbytet, n'dreq të shkojë!

Dove ci sono i cocci ci son feste. – Ku ka copa dhe thërrime, ka edhe festa e gëzime

Chi piglia bellezze, piglia corna. – Kush për grua merr bukurinë, humbet nderin dhe katandinë!

Janë shumë të rralla rastet e mospërkthimit ose të mospërsëritjes në rastet kur proverbi është përsëritur. Përkthen vetëm një herë edhe pse në origjinal është përsëritur edhe nga një personazh tjetër në të njëjtën faqe të kap.II proverbin:

Mare crespo, vento fresco. – Era me ngrica, deti me spica.

Vetëm dy fjalë të urta nuk i përkthen fare:

A provare non si perde nulla dhe Bisogna vivere come siamo nati.

Në shumë raste janë dhënë proverbat, fjalët e urta dhe shprehjet përkatëse shqipe:

Il motto degli antichi mai menti. – Sepse fjal' e plakut, trari i prakut.

Ntroi 'ntroi, ciascuno coi pari suoi. – U rrokullis tenxherja dhe gjeti kapakun!

La ragazza com'è educata, e la stoppa com'è filata. – Bijës shikoi nanën, pëlhurës shikoi anën.

Nascondere il sole colla rete. – Fshehin diellin me shoshë!

Farci il callo – qenë mësuar.

Prendere lume – Ta sqaronte çështjen.

Le rimase quella spina – I ngeli si thikë në zemër, etj.

Vetëm për një proverb mund të përdoret fjala përkthim jo i saktë:

Aiutati che t'aiuto – Ndhimomë në do të të ndihmoj.

Proverbi ka kuptimin: *Kush ndihmon veten ndihmohet edhe nga të tjerët dhe jo më ndihmo ti mua që të ndihmoj unë ty.*

PËRFUNDIME

Romani është një burim i vlefshëm për fjalorët frazeologjikë dhe një praktikë e mirë për përkthyesit e veprave artistike që kohët e fundit janë shtuar në numër, por lënë shumë për të dëshiruar në cilësi. Përkthyesi që ndërrmer një punë të tillë të dyfishtë (njohje e frazeologjisë së dy gjuhëve dhe përkthim i një veprave artistike), përdor një numër të madh fjalorësh frazeologjikë. Në shumicën e rasteve frazeologjia është kuptuar dhe përcjellë në shqip mjaft mirë. Përkthyesi ka bërë përpjekje për të krijuar edhe shprehje ose proverba, në disa raste me rimë. Lexuesi shqiptar edhe pa patur ndonjë informacion për stilin dhe veçoritë e romanit verigian, e sheh atë si një fjalorth frazeologjik.

BIBLIOGRAFIA

1. A.P. (1944), *Mbi përkthimet*. Kritika, 2, f. 65-67.
2. FEK (1928), *Përkthimi*. Nji mjet për me pasurue gjuhën. Gazeta e re, nr.9, 10 nëntor, f.3.
3. Këndonjësi (1944), *Si duhet pasuruar letërsia shqipe?* Bashkimi i Kombit, 22 janar.
4. LUVI (1940), *Mbi përkthimet letrare*. Rinija fashiste, 24 korrik.
5. SH.I. (1930), *Duhet të përkthehen Libra të Çmueshme*. Ora, nr.150, 22 gusht, f. 2.
6. STËRMILLI, H. (1934), *Mbi domosdoshmërinë dhe cilësinë e përkthimeve*. Besa, 6 prill.
7. VERGA, G. (1964), *I Malavoglia*, Mondadori, Milano, Itali.
8. VERGA, Xh. (1961), *Shtëpia e Malavolajve*, N.Sh.B. «Naim Frashëri», Tiranë.